



"Поврзување на региони"
"Bridging regions"
"Lidhja Rajonale"



THE EUROPEAN UNION'S CROSS-BORDER COOPERATION
PROGRAMME



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

"Поврзување на региони"
"Bridging regions"
"Lidhja Rajonale"
Contract No.2023/451-105

Pranuar - Primljenio Më/Dana 27-05-2024			
Nr.i organit Org.broj	Numri/Broj	Shtetëse Prilog	Vlera Vlerat e poshtme
02-	055/02-	807	

Duke u nisur nga qëllimet dhe interesat e përbashkëta në nxitjen që të kontribuojë në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve në rajonin kufitar të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, përshpejtimin e rritjes dhe nxitjen e hapjes së potencialeve të reja turistike në zonën turistike ndërkuftare midis Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut dhe veçanërisht në Komunën e Vitisë dhe Gostivarit.

Projekti gjithashtu kontribuon në Komunat: Gjilan, Kllokot dhe Partesh.

- Komuna e Vitisë rr.28 Nëntori p.n , 6100 Viti, përfaqësuar nga Kryetari, z.Sokol Halitit, dhe
- Eco-Higjena SH.P.K., Rr."Fehmi Agani" nr.17, 60000, Gjilan përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z.Senad Ramaj .

Më 27.05 2024, në kuadër të projektit "Lidhja Rajonale" për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit, e nënshkruan këtë:

MEMORANDUM PËR MIRËKUPTIMI

I. LËNDA E MEMORANDUMIT

Ky Memorandum mirëkuptimi përcakton të drejtat dhe detyrimet reciproke të palëve përbashkëpuni të ndërsjellë në kuadër të projektit për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit.

II. KOHËZGJATJA

Periudha kohore për kohëzgjatjen e Memorandumit të Mirëkuptimit është nga data 01. 06 2024 deri më 31 janar 2026.



This is a project funded by
the European Union

implemented by



In partnership





“Поврзување на региони”
“Bridging regions”
“Lidhja Rajonale”



THE EUROPEAN UNION'S CROSS-BORDER COOPERATION
PROGRAMME

III. QËLLIMI

Promovimi i sektorit të mbrojtjes së mjedisit, që në mënyrë efikase përshtatet për nevojat e mjedisit vendore dhe ndërkombëtare dhe të kontribuojë në përhpejtimin e rritjes dhe të stimulojë krijimin e vendeve të punës në zonën ndërkufitarë midis Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

IV. DETYRAT

Projekti për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit, i zbatuar nga Komuna e Vitisë dhe partnerët, Komuna e Gostivarit dhe Initiative for European Perspective, plotëson këto detyra:

- Forcimi i kapaciteteve për mbrojtje të ambientit për institucionet, ndërmarrjet e kujdesit për ambientin;
- Ngritja e vetëdijes dhe kuptimit të nevojës për një qasje të re të marketingut në mbrojtje të ambientit;
- Të kontribuojë në përmirësimin e mjedisit për shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimin, hulumtimin, si dhe zhvillimin e mbrojtjes së ambientit të përbashkët për zgjerimin e mundësive jashtë Rajonit dhe zonës ndërkufitarë lokale;
- Të kontribuojë në rritjen e ekspertizës lokale midis subjekteve private dhe publike në zhvillimin e politikave dhe standardeve në përputhje me standarde ndërkombëtare për zhvillimin e mbrojtjes së ambientit;
- Të kontribuojë në përmirësimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve për kujdesin e ambientit;
- Të kontribuojë në rritjen e njojurive dhe ndërgjegjësimin e nevojshëm për të kultivuar partneritetet dhe praktikat më të mira në fushën e mbrojtjes së ambientit, si dhe për të krijuar një rrjet i dedikuar për promovimin e zhvillimit të iniciativave për turizmin ndërkufitar midis rajonin e Vitisë dhe Gostivarit.

V. DETYRIMET

Detyrimet e Komunës së Vitisë

- Komuna e Vitisë, si lider i projektit ndërkufitar për mbrojtjen e ambientit në rajonin ndërkufitar Vitisë dhe Gostivarit, do të investoj në mbrojtje të Lumin Morava dhe promovimin e mundësive për mbrojtjen e ambientit në rajonin ndërkufitar.
- Komuna e Vitisë do të japë informacion mbi nevojat e të gjithë akterëve të lidhur me zhvillimin e mbrojtjes së ambientit, aty ku është e mundur, do të bëjë përpjekje për të ofruar kushte të favorshme për përdorimin e këtij informacioni.

Detyrimet e Eco-Higijenes



This is a project funded by
the European Union

implemented by



In partnership





“Поврзување на региони”
“Bridging regions”
“Lidhja Rajonale”



THE EUROPEAN UNION'S CROSS-BORDER COOPERATION
PROGRAMME

- Eco-Higjiena do tē ofrojë mbështetje, nē varësi tē nevojave tē projektit “Lidhja Rajonale” nē aspektin e informacionit, ekspertizës dhe përvojës. Ajo gjithashtu do tē inkurajojë ndërmarrjen e mbrojtjes së ambientit, si dhe tē gjithë akterët që tē kontribuojnë nē mënyrë aktive nē realizimin e objektivave tē projektit
- Eco-Higjiena do tē emërojë një person kontakti (zyrtar) i cili do tē jetë përgjegjës për komunikimin e projektit që është objekt i kësaj marrëveshjeje.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE


Të gjitha tē drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nē këtë Memorandum hyjnë nē fuqi pas nënshkrimit tē kësaj Marrëveshjeje.

Memorandumi përbëhet nga 4 (katër) kopje uniforme, prej tē cilave, pas nënshkrimit dhe verifikimit, nga 2 (dy) ekzemplarë u takojnë palëve kontraktuese.

Palët kontraktuese mund nē çdo kohë ta anulojnë marrëveshjen me shpjegim paraprak me shkrim nē anën tjetër, nëse konsideron se memorandumi nuk ka dhënë rezultatet e pritura, pa pasur pasoja juridike apo financiare

Eco-Higjiena SH.P.K.

z. Senad Ramaj
Drejtor Ekzekutiv



Komuna e Vitiše

z. Sokol Haxhi
Kryetari i Komunes



This is a project funded by
the European Union

implemented by



In partnership

